



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË

RAPORT TEKNIK

**“RIKONSTRUKSION DHE RIPARIM TË MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI OSE
TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA (PALLATE) TE DËMTUARA NGA TËRMETI
NË QYTETET RRËSHEN DHE RUBIK”.**

PROJEKT ZBATIM

Rrëshen, 2021

PERMBAJTJA

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

1.1 Hyrje

1.2 Vendodhja e Objekteve

1.3 Përshkrim i gjendjes aktuale te objektieve

1.4 Përshkrim i përgjithshem i Rajonit ku shtrihen objektet

1.5 Punimet e parashikuara

1.6 Normativat

2. STUDIMET E REALIZUARA

2.1 Studimi Topografik

2.2 Kushtet Klimatike dhe Hidrologjike te Zones

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

1.1 Hyrje

Programi i Shërbimeve Publike Vendore synon në një përfaqje të integruar të zhvillimit ekonomik të qytetit të Rrëshenit me përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe mbrojtjes së ambjentit, kundrejt zhvillimit urban të qytetit.

Kjo politikë ka për qëllim ofrimin me cilësi, sipas standarteve bashkëkohore të shërbimeve publike në të gjithë territorin.

Drejtimet kryesore për realizimin e Programit të Shërbimeve Publike Vendore, të materializuara në këtë detyrë projektimi, janë:

- Rehabilitimi i sipërfaqeve të fasadave ne godinat publike pjesa e qendres se qytetit.*

Për sa më sipër, objekti që trajtohet ne kete studim projektim është:

“Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) te dëmtuara nga tërmeti në qytetet Rrëshen dhe Rubik”

1.2 Vendodhja e objektit

Objekti “Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) të dëmtuara nga tërmeti në qytetet Rrëshen dhe Rubik” ndodhet brenda territorit administrativ të Bashkisë Mirdite, në pjesën qendrore të qytetit të Rrëshenit. Zona që trajtohet në këtë objekt njihet si zona e sheshit Abat Doci dhe rruga At Gjergj Fishta dhe ka një shtrirje lindje-perëndim deri mbrapa tek godina e Bashkisë së re. Kjo zonë është si edhe nga vetë emërtimi kufizohet:

Në veri me rrugën “Godina e ish-Bashkisë dhe Ura e Lumit në hyrje të Qytetit Rrëshen”.

Në jug me rrugën e Unazës së Qytetit.

Në lindje me rrugën lidhëse “Vincenzo D’Paoli”, në të dy krahët e saj,

Në perëndim me rrugën Unazës së Qytetit.

Godinat në studim sipas detyrës së Projektimit janë gjithsej 30-godina të shpërndara nëpër qytet, dhe së bashku me projektin që po zbatohet “Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) të dëmtuara nga tërmeti në qytetet Rrëshen dhe Rubik” është bërë i mundur konceptimi i plote të funksionimit të tyre.

*Një paraqitje e përgjithshme e pozicionit gjeografik të objektit **“Studim – Projektim”** “Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) të dëmtuara nga tërmeti në qytetet Rrëshen dhe Rubik” jepet në vizatimin e horografisë bashkalidhur.*

a- Pozicioni gjeografik në shkallën 1:10.000

(hartë topografike e zonës e hartuar nga Instituti i Topografisë Ushtarake)

b- Pozicioni planimerik në shkallën 1:1.000

(hartë e përgatitur nga fotot ajrore)

(hartë e përgatitur nga matjet topografike në terren)

Planvendosja

Godinat ne Rreshen



Planvendosja Godinat ne Rubik



RIKONSTRUKSION DHE RIPARIM TË MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA (PALLATE) DËMTUARA NGA TËRMETI NË QYTETET RRËSHEN DHE RUBIK”.



1.3 Pershkrimi i gjendjes aktuale te objekteve.

Objekti “Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) të dëmtuara nga tërmeti në qytetet Rrëshen dhe Rubik” *Eshte nje objekt qe mbeshtetet pergjithsisht ne rehabilitimin e te gjitha fasadave, pjese ne qendren e sheshit tashme te rikonceptuar .*

Ne keto godina ka ndërtimet para viteve 1990, 4-6 kate pergjithesisht me tulla si dhe pallate pas vitit 1990 te cilat jane me suva ne fasade por te demtuara nga Termeti. Per aresye te kohes qe ka kaluar dhe demtimeve te Termetit jane parashikuar dhe hidroizolimi me dy shtresa katrama te soletave te godinave qe nuk do te kene Cati me tjegull. Nje pjese e mire e tyre do te kene ndertimin e catise per te kryer dhe hidroizolimin dhe per te kryer dhe nje sistemim ne pershtatje estetike me njera tjetren, duke perdorur dhe korniza dhe dekore polisteroli ne fasade.

Vlerësimi fizik i objekteve: Gjatë viteve të fundit këto objekte janë degraduar dhe kanë probleme në fasada, si dhe nga demtimet nga tërmeti, dhe nga një vlerësim paraprak rezulton se: Fasadadat janë të amortizuara dhe të demtuara

Objekt i projektit do të jetë rikonstruksion i pjesshëm i godinave, rikonstruksion i fasadave, rikonstruksion i tarracës (aty ku ka nevoja), rikostruksion dhe zevendesim i vetratave ne ambientet e perbashketa.

Ndryshimi i destinacionit, nevoja për hapsira me shume, tentative për riparim apo edhe mosnderhyrja totale kanë bërë që ndertesat të jenë sot në një gjendje mjaft të amortizuar.

Nder problemet kryesore do te vecojme (duke filluar nga katet perdhe):

Nder problemet kryesore do te vecojme (duke filluar nga katet perdhe):

1. Xokoli i ndertesave nuk eshte mirembajtur, ne shume vende eshte nderhyre per shkalle apo infrastrukture dhe nuk eshte riparuar.
2. Siper ketyre carjeve sipas i eshte nderhyre duke vendosur tenda, strehe te ndryshme (metalike, betoni), reklama te cilat kane prekur edhe murin e katit te mesiperm duke shkaktuar probleme ne strukture dhe lageshtie.
3. Katet e mesiperm kane problem me gjendjen e pergjithshme te suvase e cila rezulton ne mase te madhe e amortizuar ne rrezik shembje si dhe e dekoluar.
4. Fasada ne KP ne rrugën e “At Gjergj Fishta”, eshte trajtuar jo njetrajtesisht dhe me nderhyrje nder vite.

5. Shpatulat dhe elementet e pritjes dhe kullimit te ujrave ne carjet e fasades jane te degraduar teresisht.
6. Nderhyrjet e mbylljes apo tentativat e riparimit te fasades ne katet e sipërme jane bere ne kohe te ndryshme ndaj dhe jane te palidhur ne aspektin cilesor dhe funksional me njeri tjetrin.
7. Streha e catise apo parapeti i tarraces eshte teresisht i degraduar duke perbere problem per ujrat, fasaden dhe rrezik per kalimtare.
8. Ne fasadat e pasme te ndertesave mirembajtja eshte pothuajse zero. Keto fasada jane kthyer ne fasada sherbimi, sidomos ne katin perdhe ku demtimet jane me te dukshme.
9. Infrastruktura ujore (shtesat e nyjeve HS te reja, ujrat e shiut, depozitat e ujit) eshte e gjitha ne fasade.
10. Elektrike (furnizimi me energji elektrike, sistemet e aspirimit dhe ngrohje-ftohje) eshte e gjitha ne fasade.
11. Telekomunikacion (linja internet, telefoni, tv kabllor) eshte e gjitha ne fasade.
12. Vendosja e paisjeve te kondicionimit eshte evidente ne te gjitha objektet.



RIKONSTRUKSION DHE RIPARIM TË MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA (PALLATE) DËMTUARA NGA TËRMETI NË QYTETET RRËSHEN DHE RUBIK”.



RIKONSTRUKSION DHE RIPARIM TË MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA (PALLATE) DËMTUARA NGA TËRMETI NË QYTETET RRËSHEN DHE RUBIK”.



RIKONSTRUKSION DHE RIPARIM TË MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA (PALLATE) DËMTUARA NGA TËRMETI NË QYTETET RRËSHEN DHE RUBIK”.



RIKONSTRUKSION DHE RIPARIM TË MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA (PALLATE) DËMTUARA NGA TËRMETI NË QYTETET RRËSHEN DHE RUBIK”.



RIKONSTRUKSION DHE RIPARIM TË MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA (PALLATE) DËMTUARA NGA TËRMETI NË QYTETET RRËSHEN DHE RUBIK”.



1.4 PERSHKRIM I SHKURTER MBI MIRDITEN

Rrësheni ka qene nje qytet në Shqipëri me rreth 9 200 banorë, kryeqendër e rrethit Mirditë. Ka një katedrale shumë të bukur, që është ndërtuar pas vitit 2000. Dikur qyteti i Rrëshenit quhej Fushë Lumth.

Nga studimet e bëra për zhvillimin e Mirditës , ne vitin 1990 popullsia e saj ishte rreth 12 000 banorë dhe me një numër të kufizuar ndërtimesh urbane të cilat kryesisht ishin të përqëndruara në disa zona të saj . Mbas viteve 1990 me migrimin e popullsisë kryesisht nga zonat veriore apo veri-lindore të vendit përqëndrimi i tyre në qytetin e Rrëshenit bëri që popullsia në këtë qytet të rritej dhe tashme numri i popullsisë është rreth 25 000 banorë .

Qyteti i Rrëshenit ka si pjesë kryesore të tij: Sheshin Qendror “Abat Doci” dhe rrugën kryesore të qytetit “Ate Gjergj Fishta” .

OBJEKTIVAT E NDERHYRJES

1. Prishjet të behen sipas kushteve teknike.

2. Riparim i mbulesave të ndertesave:

Te gjitha tarracat kanë nevojë të riparohen për problem lageshtie dhe të shtohet shtresa termoizoluese. Nëse në të do të vendosen depozitat e ujit atëherë do të llogariten edhe struktura ku këto të fundit të mbështeten pa demtuar shtresat e saj.

Pjesa e ndertesave që kanë pamje të drejtperdrejte nga sheshi do të mbulohen me cati me tjegulla marsejeze që të jenë dhe në sinkron me objektet e tjera (shkollat e mesme dhe konvikti).

3. Riparim i elementeve të fasadës që përbejnë rrezik për kalimtarët dhe përdoruesit e vetë ndertesës: Elemente të fasadës si xokol, kornize dritare dhe dërr, parapet tarrace ose ballkoni, strehe catie dhe hyrje në shkallë janë të gjithë për të riparuar për shkak të dëmtimeve nga tërmeti.

4. Zgjidhje për infrastrukturën e ndertesave:

Te gjithë kabllo të ndodhen nëpër fasadë do të disiplinohen. Depozitat e ujit, tuba shkarkimi tarrace/catie apo tubat e shkarkimit të ujërave të zeza që dalin në fasadë do të riparohen, izolohen, spostohen dhe “zhduken” nga fasada. Motorret e kondicionerëve, aspiratorëve etj do të kenë një rregull vendosjeje/montimi dhe funksionimi.

5. Rikualifikim estetik i ndertesave, trajtim në kompleks:

Ndërrhyrja në fasadat e ndertesave do të bëjë dhe unifikimin, “qetesimin” e saj.

Ky “qetesim” do të përfshijë materialet e përdorura në fasadë, format, ngjyrat dhe permasat e elementeve dekorativ të saj.

METODA E NDERHYRJES

Pas nje analize te gjendjes ekzistuese dhe bazuar ne Detyren e Projektimit ,duhet qe fasadat do te pastrohen nga suvaja e demtuar dhe elemente te lageshtise dhe do te risuvatohen me suva te zakonshme dhe me pas me astar dhe grafiato si dhe do te lyhen me boje hidroplastike,akrelike.

Ne lidhje me dyert dhe dritaret propozojme qe dritaret e hapësirave te perbashketa te zevendesohen duke i nderruar ne dritare dritare te reja d/alumini.

Riveshja e tarracave dhe ne disa raste mbulimi me cati me tjegulla do te perfshije heqjen e shtreses se demtuar te hidroizolimit, pastrimin e saj dhe pikave te shkarkimit, vendosjen e shtresave te reja te hidroizolimit 2KK ,si dhe riparimin e pikave te shkarkimit dhe vendosjen e kapucit te llamarines te parapetit te ri. Do te nderrohen te gjithë ulluqet vertikale dhe kasetat respektive te tarracave dhe cative.


Fasadat e katit perdhe do te unifikohen duke bere pastrime te ndryshme.

Kanalina plastike 150x50 mm per disiplinimin e infrastruktures kabllore ne fasadat e objekteve.




Fasadat kryesisht ato qe kane pamje direkt ne shesh do te trajtohen me elemente dekorativ .







RIKONSTRUKSION DHE RIPARIM TË MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA (PALLATE) DËMTUARA NGA TËRMETI NË QYTETET RRËSHEN DHE RUBIK”.



Elemente dekorativ ne dritare.



RIKONSTRUKSION DHE RIPARIM TË MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA (PALLATE) DËMTUARA NGA TËRMETI NË QYTETET RRËSHEN DHE RUBIK”.





AFATI I KRYERJES SE PUNIMEVE

Projekti parashikon qe per kryerjen e punimeve per objektin “Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) te dëmtuara nga tërmeti në qytetet Rrëshen dhe Rubik”, nevojitet nje afat prej 12 muajsh kalendarik.

Cdo objekt do te punohet ne vecanti ne menyre qe te kemi nje organizim sa me te mire te puneve

Menyra e kryerjes se punimeve jepet ne grafikun bashkelidhur raportit teknik.

ORGANIZIMI I PUNIMEVE

Theksohet qe per te gjitha proceset e punes, duhet te zbatohen me rigorozitet kushtet teknike te zbatimit te punimeve gjate ndertimit dhe te perdoren materiale per ndertim, sipas standarteve shteterore.

1.5 PUNIMET QE JANE RELIZUAR

Projekt Zbatimi eshte hartuar duke u diskutuar nje sere problemesh mbi fasadat dhe rrjetet inxhinierike te shkaktuara nga termeti dhe amortizimi nga kushtet atmosferike, efektet sociale qe sjellin nderhyrjet ne zona te caktuara etj.

Gjithashtu gjate hartimit te Projektit u bene konsultime me pushtetin lokal, Problemet e evidentuara dhe te ngritura prej tyre u rrefektuan ne Projekt Ne baze te ketyre konsultave eshte pergatitur Projekt Zbatimi i Objektit:

“Studim – Projektim “Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) te dëmtuara nga tërmeti në qytetet Rrëshen dhe Rubik”,

sherbimi i realizuar ka patur si objektiv kryesor pergatitjen e Projekt Zbatimit perfundimtar te objektit, i cili perbehet nga nenprojektet:

A-0 - TE PERGJITHSHME

A-1 Planvendosja e Objektit

A-2 Skema e Nderhyerjes

A-3 Ortografia

A-1 - GODINAT

A-1 Fasadat te mbaruara G-1-G30

B-1 RENDERA

C-1 Detaje teknike elementet dekorativ

D-1 Detaje teknike te ndryshem

Projekti eshte shoqeruar me Preventivin perkates te hartuar me çmimet e tregut dhe manualit te miratuar ne fuqi, i shoqeruar me Specifikimet Teknike dhe Raportin Teknik.

1.6 NORMATIVAT

Realizimi i ketij projekti eshte bere mbi bazen e standarteve e kushteve teknike CNR dhe ato Shqiptare dhe te konsulturara me normat e vendeve te tjera.

“Studim – “Rikonstrukcion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) te dëmtuara nga tërmeti në qytetet Rrëshen dhe Rubik”, eshte pergatitur ne perputhje me Detyren e Projektimit te dhene nga Bashkia Mirdite dhe e tejkalon ate.

1.7 KONKLUZIONE

“Rikonstrukcion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) te dëmtuara nga tërmeti në qytetet Rrëshen dhe Rubik”,

Paraqet mjaft interes ne permiresimin dhe rritjen e mireqenies te komunitetit ne pergjithesi qe banon ne keto zona por edhe te mbare qyteti ne teresi. Jeta ne qytein Rreshen duhet te jete ekuivalente me ate te qyteteve te tjere Europiane.

Trajtimi i blloqeve me tere elementet e infrastruktures rrugore dhe te atyre inxhinierike do te beje qe ata te funksionojne mire ne tere drejtimet duke i sherbyer komunitetit me tere komponentet e nevojshem jetesore.

Keto zona jane lene pas dore per vite e vite me rradhe.

Rehabilitimi i tyre do beje qe cilesia e jetes ne to te ndryshoje rrenjesisht.

ERALD-G SH.P.K
ING. GEZIM ISLAMI

RIKONSTRUKSION DHE RIPARIM TË MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA
(PALLATE) DËMTUARA NGA TËRMETI NË QYTETET RRËSHEN DHE RUBIK”.